



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

MIRATOI

MINISTËR

Anila Denaj

FTESË PËR OFERTË

28 Korrik, 2021

Kontakt

Ministrisë së Financave dhe
Ekonomisë së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e
Kombit”, Nr. 3; Tiranë,
Shqipëri

Në vëmendje të:

Mrs. Adela Xhemali

Zëvendësministër

Adela.Xhemali@financa.gov.al

Çdo pyetje në lidhje me “Ftesën për Ofertë” duhet të adresohet pranë Znj. Adela Xhemali

Ftesë për ofertë*

Jeni të lutur të paraqisni një propozim me shkrim për të vepruar si Këshilltar Financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror.

I. Konteksti dhe Objektivat

Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e tregjeve financiare për shkak të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë synon të marrë shërbim këshillimor financiar në lidhje me menaxhimin e borxhit publik, në mënyrë që të sigurojë fondet e nevojshme të huamarrjes, vlerësimin e rrezikut dhe kostos së tij, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të letrave me vlerë të qeverisë, duke rritur instrumentet e tij dhe zgjeruar bazën e investitorëve. Vlera e fondit limit është 81 768 000.00 lekë, pa TVSH.

II. Shërbimet e ofruara

Konsulenti Financiar i zgjedhur do të jetë përgjegjës për të siguruar, në emër të Republikës, shërbimet e mëposhtme:

A. Financim sovran

Historiku i kreditit dhe këshillimi për vlerësimin në kontekstin e emetimit të një Eurobondi

Vlerësimi i situatës së klasifikimit (Rating)

- i. Analiza e perceptimit të vlerësimin të Shqipërisë me S&P dhe Moody's përmes një rishikimi të thelluar të kriterëve dhe analizave të analogëve përkatës sovranë;

Përcaktimi dhe implementimi i strategjisë së vlerësimin

- i. Ndërton një përmbledhje të qartë krediti dhe histori krediti për Shqipërinë, në përputhje me strategjinë ekonomike të qeverisë dhe zhvillimet e fundit të politikës;
- ii. Ndhmon autoritetet shqiptare në përgatitjen e pyetjeve të S&P dhe Moody's në lidhje me emetimin e Eurobondit, duke siguruar që analistët e agjencisë të flasin me bashkëbiseduesit e informuar të pozicionuar më së miri për të përmirësuar perceptimin e agjencive dhe për të shqyrtuar raportet;
- iii. Siguron që të gjitha mesazhet kryesore janë argumentuar dhe përcjellë siç duhet, janë kuptuar nga agjencitë dhe janë faktuar në vendimin e vlerësimin;

B. Këshillim financimi

* Kjo ftesë për ofertë, lëshuar nga Republika e Shqipërisë, përfaqësuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, duke vepruar mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.311, datë 27.05.2021, është për përdorimin ekskluziv të personave të cilëve u adresohet në lidhje me Ofertën (siç përcaktohet këtu).

-
- i. Menaxhimi i borxhit: përgatitja e rekomandimeve mbi strategjinë e financimit që do të zbatohet në një afat të shkurtër dhe të mesëm, për të siguruar një diversifikim dhe çmim optimal për Shqipërinë, duke përfshirë ndarjen optimale midis borxhit të jashtëm dhe të brendshëm, instrumente të reja që do të synohen në monedha të ndryshme dhe huadhënësit që do të trajtohen;
 - ii. Harton opsionet përkatëse të emetimit për instrumentin e konsideruar (vlerë nominale, monedhë, maturim, kupon), brenda kornizës së një analize të qëndrueshmërisë së borxhit;
 - iii. Identifikimi i zgjidhjeve për të zbutur koston negative të mbajtjes të bashkangjitur në parapagimin e nevojave të financimit të Shqipërisë për vitin 2021-2022;
 - iv. Analizon rreziqet dhe shpërblimet e bashkangjitura në një ushtrim proaktiv të administrimit të detyrimeve të eurobondeve ekzistuese;
 - v. Transaksioni i Eurobond-it: ndihmon Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës përgatitore dhe këshillon për strukturimin e instrumenteve (termat dhe kushtet dhe negociatat me book-runners) dhe gjatë ekzekutimit të transaksioneve (përfshirë fazat të çmimit dhe alokimit);
 - vi. Në varësi të kushteve të tregut, identifikon, strukturon dhe zbaton zgjidhje alternative të financimit nëse tregu i eurobonove nuk i përshtatet nevojave të financimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
 - vii. Këshillojë mbi marrëveshjet e mundshme të shkëmbimit (norma e interesit dhe shkëmbimi i valutave) për të minimizuar rrezikun e monedhës dhe të kredisë, për të përmirësuar hyrjen e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit dhe për të optimizuar profilin e borxhit të Shqipërisë;
 - viii. Në përgatitjen e roadshow, vlerëson perceptimin aktual të rrezikut të Shqipërisë nga investitorët kryesorë financiarë, dhe identifikon masat qeveritare ose komunikimin e nevojshëm për të adresuar çdo perceptim negativ;
 - ix. Në përgatitjen e roadshow, ndihmon Shqipërinë në identifikimin dhe afrimin e investitorëve kryesorë financiarë dhe zgjeron bazën e investitorëve ndërkombëtarë.

III. Vendi dhe Frekuenca e kryerjes së Shërbimeve

Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekti i kontratës: këshilltari financiar do të asistojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, specifikisht Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj në ambientet e saj dhe kudo tjetër që të jetë e nevojshme, kurdoherë dhe aq herë sa Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

IV. Përmbajtja e Ofertave

A. Propozimi teknik përfshin:

- a. Një përshkrim të hollësishëm të shërbimeve të propozuara dhe metodologjisë, e cila përmban të gjithë informacionin e kërkuar nga ky dokument i Termave të Referencës dhe që është i mjaftueshëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në mënyrë që të vlerësohet nëse shërbimet e propozuara plotësojnë kërkesat e specifikuar këtu;
- b. Ekipin duke përfshirë përshkrimin e ekipit të plotë dhe CV e personelit kryesor;
- c. Grafikon e Zbatimit;
- d. Propozim teknik alternativ, nëse lejohet;
- e. Konfliktin e interesave: Deklaroni çdo konflikt interesi që kompania juaj mund të hasë gjatë detyrës;
- f. Sigurimin e ofertës në vlerën 2% të fondit të limit të kontratës;
- g. Të ndryshme (ju lutem shtoni çdo element tjetër që ju e konsideroni të rëndësishëm)

B. Propozimi Financiar:

Propozimi teknik duhet të dorëzohet së bashku me një propozim financiar ("propozimi financiar"). Të gjitha çmimet e propozuara duhet të jenë fikse dhe jo objekt rishikimi. Kandidati duhet të paraqesë:

- a. Tarifën për kohën e punës për një muaj për secilin person;
- b. Përmbledhjen e shpenzimeve dhe kostove direkte dhe indirekte, përfshirë taksat, tarifata, licencat, sigurimet dhe kosto të tjera që lidhen me kryerjen e shërbimeve;
- c. Çmimin total pa TVSH dhe shumën e TVSH-së nëse aplikohet;
- d. Çdo informacion tjetër që mund të kërkohej shtesë nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

V. Kriteret e përzgjedhjes:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë përcaktuar sipas pikës 11 të VKM-së Nr. 311, datë 27.05.2021.

Lidhur me rëndësinë:

<i>Kriteret e Vlerësimit</i>	<i>Pikët</i>
<i>(a) Eksperienca e ofertuesit në dhënien e shërbimeve të ngjashme:</i>	<i>[35]</i>
<i>(b) Kapaciteti për ofrimin e shërbimit të kërkuar</i>	<i>[50]</i>
<i>(c) Oferta Ekonomike</i>	<i>[15]</i>

Vlerësimi i Propozimeve (Ofertave) kryhet duke marrë parasysh specifikisht kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit	Pikët
1. Eksperienca e ofertuesit në dhënien e shërbimeve të ngjashme	[35]
Nënkriteret	

-Përvoja për punë të ngjashme 40-80%

Ofertuesit, të vlerësohen sipas kontratave të suksesshme të ngjashme me objektin e shërbimit të kërkuar.

-Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Ofertuesit të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e komisionit të vlerësimit në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

2. Kapaciteti për ofrimin e shërbimit të kërkuar [50]

Nënkriteret

- | | |
|---|----------|
| a) Përqasja teknike dhe metodologjia | [20-30%] |
| b) Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit | [30-40%] |
| c) Organizimi i Stafit | [20-30%] |
- a) **Përqasja teknike dhe metodologjia:** Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).
- b) **Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlydhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumenteve përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.
- c) **Organizimi dhe Staf:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ. Në çdo rast, anëtarët e komisionit të vlerësimit në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

3. Oferta Ekonomike

[15]

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për eksperiencën e ofertuesit në dhënien e shërbimeve të ngjashme: X = (pikët x 0.35)

Pesha për kapacitetin për ofrimin e shërbimit të kërkuar: Y = (pikët x 0.5)

Pesha për Ofertën Ekonomike: Z = (pikët x 0.15)

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y + Z$$

Ofertuesi që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

VI. Procesi i dorëzimit

Zarfi i vulosur duhet të dorëzohet në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i mbyllur dhe jotransparent,

Nënshkruar dhe me këto shënime:

- adresën;
- Shënimin: Propozimi për Konsulencë Financiare
- datën dhe orën e hapjes së zarfit;
- emrin e ofertuesit;

Të dy gjuhët Anglisht ose Shqip do të pranohen për Ofertën dhe të gjitha korrespondencat / dokumentet në lidhje me Ofertën dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Zarfi duhet të dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **deri më 17 Gusht 2021, ora 14:00, me kohën e Tiranës**. Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezervon të drejtën të refuzojë çdo propozim që nuk është marrë deri në këtë kohë.

Propozimet do të hapen nga komisioni i vlerësimit të ofertave më datë 17 Gusht 2021,

ora 14:15 me kohën e Tiranës.

VII. Konflikti i interesit

Këshilltari financiar duhet të angazhohet, gjatë gjithë misionit, të sigurojë këshilla profesionale, objektive dhe të paanshme dhe të ruajë, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, interesat e Republikës së Shqipërisë. Këshilltari ligjor duhet të shmangë situatat e konfliktit të interesit me misionet ose interesat e tjera.

VIII. Konfidencialiteti

Dokumentet dhe të dhënat që do të jenë në dispozicion të ministrisë do të konsiderohen konfidenciale dhe nuk duhet të transmetohen tek palët e treta.

IX. Informacion tjetër

Kjo kërkesë për propozime nuk është një angazhim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të pranuar propozime. Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezervon të drejtën të pranojë ose të refuzojë çdo dhe të gjitha propozimet, të negociojë modifikimet e propozimeve të paraqitura dhe të heqë dorë nga çdo parregullsi ose informalitet në çdo propozim.

Pas marrjes së propozimeve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mund të kërkojë nga kandidati që të bëjë prezantime me gojë ose t'i përgjigjet thirrjeve telefonike për të sqaruar propozimin e tij. Mund të zhvillohen intervista dhe diskutime me kandidatët nën shqyrtimin përfundimtar para se të bëhet një përzgjedhje e fituesit; megjithatë, propozimet mund të pranohen pa prezantime ose diskutime të tilla.

Asnjë kosto e lidhur me përgjigjen ndaj kësaj Kërkese për Propozim ose marrjen në intervista nuk do të rimbursohet.

Pasi të zgjidhet finalisti, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të negociojë një marrëveshje që do të jetë në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja do të përfshijë të gjitha aspektet e propozimit të përshkruar këtu.